



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI QENDROR I ZGJEDHJEVE

KOMISIONERI SHTETËROR I ZGJEDHJEVE

Data: 23 Prill 2021

Nr. 278

VENDIM

Objekt: Për shqyrtimin e denoncimit për shkelje të parashikuar në udhëzimin nr. 6, datë 23.03.2021 të Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve ndaj Partisë Socialiste të Shqipërisë.

Kërkues: Denoncues

Ndaj: Partisë Socialiste të Shqipërisë

Baza ligjore: Neni 19, pika 1, shkronjat “dh”, “f” dhe “n”, pika 2, 79 të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008, “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, nenet 60, 61, dhe vijues të ligjit nr. 44/2015, “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë”, vendimi nr. 9 datë 24.12.2020 udhëzimi nr. 6, datë 23.03.2021 “Për përdorimin e materialeve propagandistike edukuese dhe rregullat për afishimin e tyre gjatë fushatës zgjedhore” të Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve

Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve, pasi shqyrtoi relacionin e administratës paraqitur nga Sekretari i Përgjithshëm i KQZ-së gjatë procesit të hetimit administrativ,

VËREN:

Në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve, në datën 19.04.2021 nëpërmjet e-mail denoncime.kqz@gmail.com, jemi njoftuar për vendosjen e materialeve propagandistike në favor të Partisë Socialiste të Shqipërisë, në kundërshtim me nenin 79, pika 2 e ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008,



Data: 23 Prill 2021
Nr. 278

Për shqyrtimin e denoncimit për shkelje të parashikuar në udhëzimin nr. 6, datë 23.03.2021 të Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve ndaj Partisë Socialiste të Shqipërisë

“Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar dhe me nenin 3, pika 1 e udhëzimit nr. 6 datë 23.03.2021, të Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve.

Në këtë kallëzim pretendohet se: *“Në distancë 5 (pesë) metra nga qendra e votimit dhe në kundërshtim me udhëzimin e KQZ dhe me ligjin vendoset banderola e Partisë Socialiste”*.

Bashkëlidhur këtij denoncimi është dërguar dhe një fotografi si provë e denoncimit.

Sipas përcaktimeve të neneve 19, pika 1, shkronja “dh” dhe “f”, pika 2, dhe 91, 92, të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008, “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve ka kompetencat si më poshtë:

- dh) kujdeset për zbatimin e këtij ligji në mënyrë të drejtë, të përpiktë, të saktë dhe uniforme nga të gjitha institucionet, subjektet apo personat e ngarkuar me detyra dhe detyrime, sipas ligjit;
- f) monitoron nëpërmjet administratës së KQZ-së apo subjekteve të kontraktuara sjelljen e institucioneve publike gjatë fushatës dhe përdorimin e burimeve publike.

Sipas përcaktimeve të nenit 23, të ligjit nr. 44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë”, Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve shqyrtoi paraprakisht kërkesat lidhur me kompetencën e organit publik për shqyrtimin e tij.

Referuar nenit 7 të ligjit 10279 datë 20.05.2010 “Për kundravajtjet administrative”, kompetenca për konstatimin e kundërvajtjes, me përjashtim të rasteve kur ligji parashikon ndryshe, i takon organit administrativ, përgjegjës për zbatimin e ligjit të posaçëm, titullarit të organit administrativ, që merret me zbatimin e ligjit, në rastet kur ligji nuk shprehet për kompetencën për shqyrtimin e kundërvajtjes dhe nxjerrjen e vendimit përkatës.

Referuar nenit 82, e vijues të ligjit nr. 44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë”, Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve çmon se, të dhënat e paraqitura nga kallëzuesi përbëjnë indicie të besueshme për të filluar një procedurë administrative



II.

Rrethanat e faktit

Në datën 19.04.2021, nëpërmjet email jemi vënë në dijeni për përdorjen e materialeve propagandistike nga Partia Socialiste e Shqipërisë.

KQZ, në datë 19.04.2021, nëpërmjet email-it, i ka kërkuar drejtorisë përgjegjëse autorizimin e një personi për të kryer verifikimet nëse banderola, objekt denoncimi, është e afishuar në vendndodhjen e pretenduar nga denoncuesi.

Personi i autorizuar nga KQZ, në datën 20.04.2021, ora 13:00, në raportin mbi shkeljet e vërejtura gjatë monitorimit të zgjedhjeve për Kuvend të datës 25 prill 2021, ka raportuar se në rajonin Babrru Shpat, njësi administrative Bashkia Kamëz, ka konstatuar shkelje të parashikuara në udhëzimin nr. 6 datë 23.03.2021 të Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve. Në përshkrimin e këtij raporti thuhet se “*Shkelja ka ndodhur para tre ditësh, përkatësisht në datën 17.04.2021, në bashkinë Kamëz, Babrru Shpat, të Paskuqanit. Veprimi që përbën shkelje, është vendosja e posterit të Partisë Socialiste, me kandidate për deputete zj. Dallëndyshe Bici, mbi 4 (katër) qendrat e votimit nr. 2041, në distancë ajrore 5 metra.*”

III

Analiza juridike dhe konkluzione

Referuar nenit 2, pika 31, të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008, “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, “... *materiale propaganduese statike janë materialet që i shërbejnë subjektit zgjedhor për promovimin e fushatës zgjedhore dhe që janë vendosur ose afishuar në vende ose hapësira publike me akses publik, si shtyllat e ndriçimit të rrugëve, fasadat e ndërtesave, sheshet, pjesët ballore të dyqaneve ose ndërtesave, përgjatë rrugëve të qyteteve, rrugëve ndërqytetëse etj.*”

Referuar neni 78, pika 1, të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008, “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, “...*gjatë fushatës zgjedhore çdo subjekt zgjedhor ka të drejtë të bëjë propagandë zgjedhore në çdo mënyrë të ligjshme.*”

Referuar pikës 1, të nenit 79, të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008, “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, parashikohet se... “*Jo më vonë se 35 ditë para datës së zgjedhjeve, kryetari i bashkisë, në mënyrë të drejtë dhe të paanshme, përcakton vendet publike në territorin e bashkisë, përkatëse për afishimin prej partive politike dhe subjekteve zgjedhore të materialeve propagandistike. Vendet e caktuara duhet të jenë në ambiente që sigurojnë shikueshmëri publike dhe të kenë hapësirë të mjaftueshme ku të gjitha subjektet zgjedhore që marrin pjesë në zgjedhje të paraqesin programet e tyre*”



zgjedhore dhe mesazhet zgjedhore. Vendimi i kryetarit të bashkisë bëhet publik në faqen e internetit të bashkisë menjëherë pas miratimit.

Referuar pikës 2, të nenit 79, të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008, “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, parashikohet se... “*Gjatë fushatës zgjedhore përdorimi dhe afishimi i çdo materiali tjetër statik për propagandë zgjedhore, përfshirë flamujt dhe posterat, lejohet vetëm në një largësi prej deri 5 metrash nga zyra zgjedhore e partisë politike apo subjektit zgjedhor përkatës*”.

Në zbatim të neneve të sipërcituara, Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve, nëpërmjet udhëzimit nr. 6, datë 23.03.2021 “Për përdorimin e materialeve propagandistike edukuese dhe rregullat për afishimin e tyre gjatë fushatës zgjedhore” në nenin 5, pika 1, e tij parashikohet se zyrat zgjedhore të subjekteve zgjedhore mund të hapen në një distancë jo më të vogël se **300 (treqind) metra nga vendndodhja e KZAZ-ve, QV-ve dhe VNV-ve.**

Referuar denoncimit të mësipërm dhe provave të administruara gjatë hetimit administrativ, Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve vlerëson se, vendosja e materialeve propogandistike nga subjekti zgjedhor apo kandidatët e tyre është mjet i ligjshëm për bërjen e propagandës zgjedhore, por kjo duhej të kryhej në përputhje me nenin 79, pika 1 dhe 2, të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008, “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, si dhe në përputhje me neni 5, pika 1, të udhëzimit nr. 6 datë 23.03.2021 të Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve. Materiali propagandues statik, e tipit banderolë, e vendosur mbi 4 qendrat e votimit në një largësi më të vogël se 5 metra ajror, bie në kundërshtim të hapur me dispozitat e sipërcituara.

Referuar nenit 79, pika 5, të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008, “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar dhe nenit 7, të udhëzimit nr.6 datë 23.03.2021 “Për përdorimin e materialeve propagandistike, edukuese dhe rregullat për afishimin e tyre gjatë fushatës zgjedhore”, të Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve, ngarkohet policia bashkiake për zbatimin e detyrimeve që rrjedhin nga Kodi Zgjedhor dhe nga udhëzimi nr. 6 datë 23.03.2021, **duke hequr menjëherë çdo material propagandues të subjekteve zgjedhore të vendosura jashtë vendeve të lejuara.**

PËR KËTO ARSYE:

Bazuar në nenet 19, pika 1, shkronjat “dh”, “f”, “n”, pika 2, 78 pika 6, 79, 91, të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008, “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, nenet 60, 61, dhe vijues të ligjit nr. 44/2015, “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë”, vendimi nr. 9 datë 24.12.2020 të Komisionit Rregullator në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve,



udhëzimi nr. 6, datë 23.03.2021 “Për përdorimin e materialeve propagandistike edukuese dhe rregullat për afishimin e tyre gjatë fushatës zgjedhore” të Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve:

V E N D O S:

1. Policia bashkiake të marrë masa të menjëhershme për heqjen e materialit propagandues të Partisë Socialiste të Shqipërisë.
2. Rezultatet e këtij vendimi i njoftohen me postë elektronike denoncuesit.
3. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Komisionin e Ankimeve dhe Sanksioneve, brenda 3 (tre) ditëve nga hyrja e tij në fuqi.
4. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në faqen zyrtare të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve.

Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve

Ilirjan CELIBASHI

